



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:150984

Datë: 10.10.2022

Numri i dokumentit: 03696064

**P.nr.177/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Hoxha, si dhe me sekretarin juridik Ilvi Raba, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit E. L. nga Rahoveci, për shkak të veprave penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.590/19 të datës 28.06.2019; për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1937/2016 të datës 21.03.2017; për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.252/17 të datës 12.10.2017; për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.567/2017 të datës 26.01.2018; për shkak të veprës penale *Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.550/18 të datës 03.09.2018; për shkak të veprës penale *Sulmi 187 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.129/2017 të datës 13.12.2017, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, publik, me datë 23.09.2022, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Qazim Xharra, të akuzuarit E. L., mbrojtësi i të akuzuarit av. R. B., sipas detyrës zyrtare, më datë 26.09.2022, vendosi dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10 Tetor 2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***I akuzuari,***

**E. L.**, i lindur me datë ....., në Rahovec, nga i ati R. dhe e ëma Sh., e gjinisë H., me vendbanim në Rahovec, rruga “B. I.”, p.nr., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

***Sepse:***

**I.** Me datë të pavërtetuar e gjatë vitit 2018, në rrugën “B. I.” në Rahovec, me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim të fitimit, së bashku me të miturin D.H. ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit H. T., ashtu që duke shfrytëzuar mos prezencën e tij pasi jeton në Gjermani, është futur në shtëpinë e të dëmtuarit në atë mënyrë që fillimisht kanë

kaluar murin rrethues dhe pastaj me forcë kanë hapur derën hyrëse ku nga podrumi i shtëpisë kanë marr pajisje të punës si: gypa të ujit, gjenerator elektrik, fshesë elektrike, shpuese elektrike, sharrë elektrike, hilt, brava të dyerve, një reflektor të aluminit, aparat të kafes, dush për banjo, qeshmë, si dhe pajisje të tjera të sanitaris dhe kuzhinës, me ç ‘rast me këto veprime të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material rreth 2,000.00€.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 të KPRK-së.

**II.** Se mes datave 25-28.11.2016, në kohë të pacaktuar, në rrugën “Xh. K.” në Rahovec, pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit A. B., me qëllim që vetit, t’i sjellë përfitim pasurorë të kundërligjshëm, tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme, në atë mënyrë, që i pandehuri duke shfrytëzuar mos prezencën e të dëmtuarit i cili së bashku me familjarët tij për disa ditë ishte në Prizren, duke përdorur mjete të forta hap derën e shtëpisë hyn brenda, ku ka vjedhur një Tv-plazma, tre tupanë, dy zmadhues për muzikë e më pas largohet nga vendi, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material rreth 2,500.00€.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 të KPRK-së.

**III.** Në mes datës së pavërtetuar 15 dhe 16.04.2016 rreth orës 21:00, në shtëpinë e të dëmtuarit A. A. në Rahovec, në rrugën “Xh. e R. K.”, me qëllim të përvetësimit pasuror të kundërligjshëm, ndajnë rolet dhe përgjegjësitë së bashku me të miturin D.H. ashtu që shfrytëzojnë momentin e përshtatshëm duke përdorur forcën kanë depërtuar brenda në shtëpinë e të dëmtuarit dhe tek depoja marrin dy aparate saldues, një me CO2 dhe një me elektroda si dhe një cercullar elektrik “Vollager”, duke ikur nga vendi i ngjarjes, me ç/rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 650€.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 të KPRK-së.

**IV.** Në mes datave 01-14.11.2016 në rrugën “Il. K.”, në Rahovec, me qëllim të përvetësimit të sendit të huaj në mënyrë të kundërligjshme, me qëllim të fitimit si dhe duke shfrytëzuar mos prezencën e të dëmtuarit, ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit F. R. ashtu që me mjet të ortë ka hapur derën e hyrjes së shtëpisë duke depërtuar brenda dhe nga aty merr një TV Plazma “Led Elkos”, në vlerë prej 150 euro, një kompjuter në vlerë prej 120 euro si dhe një hidrofor të ujit me vlerë prej 150 euro, duke i shkaktuar dëm material të dëmtuarit në vlerë prej 420€.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par. 1 të KPRK-së.

**V.** Me datë 23.01.2018, në lagjen e “Epërme” në Rahovec, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për personin tjetër, duke vepruar me të miturin D.H. ia marrin pasurinë të dëmtuarit F. Rr. nga Rahoveci, në atë mënyrë që duke shfrytëzuar momentin e volitshëm, mungesën e të dëmtuarit, në orët e vona të natës, hyjnë në podurm-shup, që gjendet në shtëpinë e të dëmtuarit e cila ka qenë e hapur dhe nga aty marrin një gjenerator, një fleks, një mikser për përzierjen e gipsit dhe një Tv të vjetër, në vlerë të përgjithshme prej 340€.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

**VI.** Më datë 24.01.2017 rreth orës 10:00, ne vendin te “Rrasat”, në Rahovec, me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit A. D., në atë mënyrë që ditën kritike pasi që i dëmtuari del nga vendi i punës, aty është takuar me të akuzuarin E., i cili ju ka drejtuar me fjalët “kush je ti që ke hy në oborrin tim dhe ma ke vjedhur qenin dhe dy ogjak”, deri sa i dëmtuari i përgjigjet se “qeni është i imi dhe e kam marr” atë herë i akuzuari i revoltuar e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grushte në fytyrë, deri sa i dëmtuar është larguar dhe ka shkuar në vendin e tij të punës.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 17, 21, 41, 41 par. 1 pika 1.1, 43 par. 1 pika 1.2 dhe 1.3, 42 par.1, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 248, 365 si dhe 370 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

Për veprën penale si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton) dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro.

Për veprën penale si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton) dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro.

Për veprën penale si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton) dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro.

Për veprën penale si në pikën **IV** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton) dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind (150) Euro.

Për veprën penale si në pikën **V** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton) dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjet (10) muaj, dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) Euro.

Për veprën penale si në pikën **VI** të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton (cakton) dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj.

Gjykata, në harmoni me nenin 80 të KPRK-së, të akuzuarit E. L. për të gjitha veprat penale, i shqipton këtë:

**DËNIM UNIK ME BURGIM DHE ME GJOBË**

Duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) vite e tre (3) muaj, dhe dënim me gjobë në shumën prej shtatëqind (700) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, atëherë ky dënim me gjobë do të zëvendësohet me dënimin më burgim, duke llogaritur çdo njëzet (20) Euro me një (1) ditë burgim.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse i akuzuari e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e tij, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër në punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë.

Të dëmtuarit, H. T., i lindur më datë ... në Rahovec, me numër personal ...; A. A., i lindur më datë ... në Rahovec, me numër personal ...; A. B., i lindur më datë ... në Prizren, me numër personal ...; F. Rr., i lindur më datë ... në Rahovec, me numër personal ... dhe A. D., i lindur më datë ... në Rahovec, me numër personal ..., për kompensimin e dëmit udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko civil.

I akuzuari B. H. obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzet (20) Euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej tridhjetë (30) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### *A r s y e t i m*

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën, kundër të akuzuarit E. L. nga Rahoveci, për shkak të veprave penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.590/19 të datës 28.06.2019; për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1937/2016 të datës 21.03.2017; për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.252/17 të datës 12.10.2017; për shkak të veprës penale *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.567/2017 të datës 26.01.2018; për shkak të veprës penale *Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.550/18 të datës 03.09.2018; për shkak të veprës penale *Sulmi 187 par.1 të KPRK-së*, i akuzuar sipas

aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.129/2017 të datës 13.12.2017.

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret, veprat penale janë kryer në Rahovec, andaj Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konsideron se me qenë se për veprat penale për të cilat akuzohet i akuzuari janë të dënueshme më pak se 10 vite burgim dhe meqenëse të njëjtat vepra nuk janë paraparë me nenin 22 të KPPRK-së, atëherë gjykata konstaton se departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës, PP/IL.nr.590/2019 të datës 28.06.2019, më datë 23.09.2022 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar gjyqësor, ku të pranishëm kanë qenë Prokurori i shtetit Qazim Xharra, i akuzuari E. L. me mbrojtësin e tij av. R. B. i angazhuar sipas detyrës zyrtare.

Gjykata, në seancën e datës 23.09.2022, sipas propozimit të palëve dhe në kuptim të nenit 35 par.8 të KPPRK-së, ka marr aktvendim për bashkimin e procedurës penale ndaj të akuzuarit E. L. nga Rahoveci, dhe atë si vijon: P.nr.177/2019, datë 12.07.2019, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së; P.nr.38/2018 të datës 01.02.2018, për shkak të Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së; P.nr.111/2017 të datës 21.03.2017, për shkak të Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së; P.nr.316/2017 të datës 18.10.2017, për shkak të Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së; P.nr.353/2018 të datës 13.09.2018, për shkak të Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së; P.nr.418/2017 të datës 13.12.2017, për shkak të Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së dhe procedura e bashkuar për këto çështje penale, zhvillohet në një lëndë të vetme, nga gjyqtari i vetëm gjykues, e cila mban numrin e lëndës P.nr.177/19.

Pas leximit të aktakuzës (aktakuzave të lartcekura) nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pas njoftimit në kuptim të nenit 246 të KPRK-së, lidhu me pranimi pranimin apo mos pranimin e fajësisë, i akuzuari E. L. ka deklaruar se: e pranon fajësinë për të gjitha veprat penale për të cilën e ngarkon Prokuroria Themelore në Gjakovë, duke shtuar se edhe më parë në deklaratat e dhëna në polici e ka pranuar fajësinë, ndihet i penduar për këto veprime, tani janë në vuajtje të dënimit andaj dhe është deklaruar se ndjehet shumë i penduar për të gjitha këto gjëra që i ka bërë, tutje nga gjykata ka kërkuar që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e vendosjes të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, njëkohësisht palëve të dëmtuara ju ka kërkuar falje.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. R. B., lidhur me pranimin e fajësisë të bërë nga i mbrojturi i tij, ka deklaruar se: në tërësi e mbështet deklarin e të mbrojturit tim, i pandehuri të gjitha këto veprat penale i ka kryer në një moshë bukur të re, ka ndikuar pa pjekuria e tij, është rritë në mungesë të të atit pasi që i ati i ka vdekur kur ka qenë si fëmijë para shumë viteve, gjendjen materiale apo ekonomike i ka shumë të dobët, dhe pasi që i njëjti pranojë që ka kryer këto veprat penale për çka akuzohet i propozon gjykatës që pranimin ta merre si rrethanë lehtësuese dhe të ia shqiptojë një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit, Qazim Xharra lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit të fillestar gjyqësor ka deklaruar se: duke pas parasysh se i akuzuari e pranojë fajësinë të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe faktet se i njëjti ka kuptuar natyrën, pasojat dhe favoret e pranimit të fajit, pranimi i fajit u bë vullnetarisht nga i pandehuri po ashtu fakti se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes respektivisht provave materiale dhe personale që përmban aktakuza e në bazë të cilave edhe është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të këtyre aktakuza PP/II nr.590/2019 e datës 28.06.2019, PP.nr.567/2018 datës 26.01.2018, PP/II.nr. 1937/ 2017 datë 21.03.2017, PP/II.nr.252/2017 datë 12.10.2017,PP/II.nr.550/2018 datë 03.09.2018, PP.nr.129/2017 datë 13.12.2017 me çka edhe përmbushen edhe elementet qenësore të veprave penale për të cilën ngarkohet këtu i akuzuari po ashtu edhe fakti se aktakuzat janë të ligjshme, dhe se provat të cilat i përmbajnë këto aktakuza janë provat të nxjerra në bazë të rregullave të përgjithshme mbi provat, prokuroria e shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë. Gjykatës i propozoj që të akuzuarin të shpallë fajtor dhe të i shqiptojë një dënim të paraparë me ligje duke pasi parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprave penale për të cilat ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh qëllimin e dënimit si dhe rrethanat lehtësuese pranimi i fajit, pendimi i thellë, kërkim falje publike këtu para gjykatës, ndërsa sa i për ketë rrethanave rënduese të ketë parasysh faktin se i njëjti është recidivist i veprave penale të natyrave vepra këtu akuzohet si dhe veprave më të rënda si dhe të obligohet në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Pasi gjyqtari i vetëm gjykues u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën, benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 248 të KPPRK-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të akuzuarit, për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale.

Gjykata, gjendjen faktike në raport me veprat penale, të përshkruar në aktet akuzuese dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga të bërë nga i akuzuari, ku për shkak të pranimit të fajësisë, gjykata fare nuk i ka administruar provat e çështjes.

Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 257 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme, gjithashtu në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale për të cilat akuzohet. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktet akuzuese, e për të cilat i akuzuari ka qenë i

njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i ka kundërshtuar, por ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së, në pajtim me faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprave penale: *Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së, Vjedhja nga neni 325 par.1 të KPRK-së dhe Sulmi 187 par.1 të KPRK-së*, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73, 74 dhe 75 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë rënduese mori shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, gjykata si rrethanë tjetër rënduese gjeti se i akuzuari është përsëritës i veprave penale të natyrës së njëjtë dhe të natyrave të tjera (bazuar në raportin e të kaluarës kriminale si dhe i njëjti është në vuajtje të dënimit për vepra tjera penale), veprat penale përfshin disa të dëmtuar, i njëjtit ka bashkëpunuar në kryerjen e veprave penale dhe me persona të mitur si dhe numrin e veprave penale të kryera dhe të bashkuara në këtë procedurë penale. Ndërsa si rrethana lehtësuese vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i akuzuari për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimi i thellë për kryerjen e veprës penale, ku që nga faza e hershme e hetimeve, e po ashtu edhe gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor, ka theksuar se është penduar për atë që ka bërë, bashkëpunimi i tij me gjykatën, si dhe keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari për rastin e ndodhur.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtit i shqiptoj dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej shtat (7) vite e tre (3) muaj, dhe dënim me gjobë në shumën prej shtatëqind (700) Euro, i cilin dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Gjykata përkitazi me dënimin e shqiptuar mori për bazë sjelljet e mëparshme të kryesit, siç janë dënimet e mëparshme për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe të natyrave tjera si dhe shkalla e lartë e përgjegjësisë penale – fajësisë. Gjykata duke vendosur për lartësinë e dënimit me gjobë mori për bazë rrethanat financiare të akuzuarit, pasi që i njëjti është i gjendjes se dobët ekonomike, është i pa punë, konkretisht është në vuajtje të dënimit për një vepër tjetër penale andaj i shqiptoj minimumin e dënimit me gjobë për secilën vepër penale. Tutje, gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen e kryesit, me rrethanat e kryerjes, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, si dhe me përgjegjësinë e kryesit. Sipas bindjes së gjykatës, ky dënim përveç që do të mundësoj risocializimin dhe riedukimin e kryesit, i njëjti do të ndikoj edhe tek tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjegjësisht do të ndihmoj në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me detyrimin për respektimin e ligjit, e çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së.

Nga konstatimet e lartcekura, kjo gjykatë ka bindje se në rrethanat e rastit, duke marr parasysh motivet për të cilat është kryer vepra penale, e ne veçanti sjellja e mëparshme e kryesit, në asnjë rrethanë kryesit të lartcekur nuk mund ti shqiptohet ndonjë dënim tjetër alternativ përveç se atij me burgim efektiv.

Mbi bazën e të dhënave të lartcekura, gjykata ka konsideruar se edhe dënimi unik prej shtatë (7) vite e tre (3) muaj burgim dhe dënimi me gjobë prej 700 € është i mjaftueshëm dhe në proporcion me rrethanat rënduese dhe lehtësuese që i ka trajtuar kjo gjykatë.

Në rastin konkret siç është theksuar edhe më sipër, po që se gjykata nuk do të gjente asnjë rrethanë lehtësuese, marrë për bazë rrethanat rënduese të rastit, të akuzuarit do t'i shqiptonte dënim edhe më të ashpër. Megjithatë kjo gjykatë konsideron që ky dënim është i mjaftueshëm dhe i domosdoshëm që i akuzuari ta kuptoj rëndësinë e veprës penale që e ka kryer e po ashtu edhe rëndësinë që ka për pasojë sanksioni penal.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, duke marrë parasysh faktin se të dëmtuarit nuk kanë prezantuar në shqyrtimin fillestar e po ashtu duke marr parasysh faktin se nuk dihet saktë vlera e të gjitha sendeve veç e veç dhe vlera e tërësishme e dëmit, gjykata të dëmtuarit lidhur me realizimin e kërkesës pasurore-juridike konform nenit 463 paragrafi 2 të KPPRK-së, i udhëzon në kontest juridiko-civil.

Gjykata, konform nenit 450 par.2 nën par.6 të KPPRK-së, të akuzuarin e ka obliguar që të paguaj shumën prej njëzet (20) Euro në emër të paushallit gjyqësor. Po ashtu, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit *Nr.05/L-036* për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej 30 euro në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.177/19, datë 10 tetor 2022**

Sekretari juridik,  
Ilvi Raba

---

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Dardan Hoxha

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.